



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr.35/5 prot.

Tiranë, më 11.2.2026

V E N D I M

Nr. 14, datë 11. 2. 2026

**MBI PËRFUNDIMIN E VERIFIKIMIT TË LIGJSHMËRISË SË VEPRIMEVE
ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS SË
KONKURRIMIT ME KOD #7251, PËR PLOTËSIMIN E POZICIONIT
“SEKRETAR I PËRGJITHSHËM”, NË INSTITUCIONIN E PREFEKTIT TË
QARKUT SHKODËR, TË SHPALLUR NGA DAP**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit me kod #7251, për plotësimin e pozicionit “Sekretar i Përgjithshëm”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr.1172 prot., datë 29.12.2025 ka administruar informacionin e sjellë nga kandidatja Hermina Albunesa, pjesëmarrëse në procedurën e konkurrimit me kod #7251, “Shpallje për lëvizje paralele, ngritje në detyrë, në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”, për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm në Administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër - klasa e pagës III-1”, të

shpallur nga DAP, në të cilin ngrihen pretendime, për shkelje të kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil, të cilat normojnë institutin e rekrutimit.

Nga shqyrtimi i informacionit të dërguar pranë Komisionerit me shkresën nr.1172 prot., datë 29.12.2025, rezulton se kandidatja Hermina Albunesa ka aplikuar për të marrë pjesë në fazën e lëvizjes paralele, në procedurën e konkurrimit për plotësimin e pozicionit “*Sekretar i Përgjithshëm në Administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër*”, klasa e pagës III-1, shpallur nga DAP, me kod #7251.

Pas njoftimit mbi rezultatet individuale të vlerësimit, kandidatja, duke mos qenë dakord me rezultatin e marrë, ka paraqitur ankesë pranë DAP-it, me anë të cilës ka kërkuar rivlerësimin e intervistës së strukturuar me gojë.

Në informacionin e përcjellë pranë Komisionerit parashtrohet se procedura e ndjekur nga Komiteti i Pranimit për Lëvizje Paralele (KPLP) gjatë vlerësimit të intervistës dhe rivlerësimit të kandidates Hermina Albunesa, ka qenë në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil. Gjithashtu, pretendohet se nuk i është vënë në dispozicion kopje e regjistrimit të intervistës së strukturuar me gojë, si dhe aktet përkatëse të hartuara nga KPLP-ja.

Në këto kushte, kandidatja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim konstatimin e shkeljeve ligjore të pretenduara dhe rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka nisur procesin e verifikimit të informacionit, nëpërmjet shkresës nr.35 prot., datë 08.01.2025, me objekt: “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të ardhur me shkresën nr. 1172 prot., datë 29.12.2025, pranë Komisionerit, të dërguar nga kandidatja Hermina Albunesa*”, ka vënë në dijeni institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër dhe Departamentin e Administratës Publike për fillimin e verifikimit të procedurës së konkurrimit, si dhe ka kërkuar dokumentacionin përkatës.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër, me shkresën nr.31/1 prot., datë 19.01.2026, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 35/1 prot., datë 21.01.2026, ka informuar se nuk ka pasur përfaqësues në KPLP, për rrjedhojë, nuk disponon dokumentacion lidhur me aplikimin e kandidates apo raportin e vlerësimit.

Ndërsa, Departamenti i Administratës Publike, nëpërmjet shkresës nr. 5636/3 prot., datë 22.01.2026, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 35/2 prot., datë 23.01.2026 dhe nr.

35/3 prot., datë 26.01.2026, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri, nga përmbajtja e së cilit rezulton se, në zbatim të nenit 26, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe të pikës 16, të kreut II, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, me Urdhërin nr.635, (nr. 5498/2 prot.), datë 07.11.2025, është ngritur Komiteti i Pranimit për Lëvizje Paralele, me përbërje si më poshtë vijon:

- Znj. Era Dragoti, Përgjegjës i Sektorit të Politikave, në Drejtorinë e Politikave dhe Koordinimit për Menaxhimin e Territorit, në Drejtorinë e Përgjithshme e Politikave të Rendit, Sigurisë Publike dhe Çështjet Territoriale, në Ministrinë e Punëve të Brendshme - përfaqësues nga institucioni, i zgjedhur nga DAP;
- Z. Arben Xhaferi, Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Koordinimit për Menaxhimin e Territorit, në Drejtorinë e Përgjithshme e Politikave të Rendit, Sigurisë Publike dhe Çështjet Territoriale, në Ministrinë e Punëve të Brendshme - eprori direkt;
- Znj. Matilda Hysa, Specialist në Sektorin e Procedurave të Rekrutimit, në Drejtorinë e Rekrutimit në Shërbimin Civil, në Departamentin e Administratës Publike.

Në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, të Këshillit të Ministrave, DAP ka shpallur procedurën e konkurrimit për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë, për plotësimin e pozicionit “*Sekretar i Përgjithshëm në Administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër*”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër, klasa e pagës III-1.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, njësia përgjegjëse DAP, në përfundim të procesit të verifikimit paraprak dhe verifikimit përfundimtar, në fazën e lëvizjes paralele, ka kualifikuar për të vijuar në fazën e dytë të konkurrimit, kandidaten e vetme Hermina Albunesa, duke e njoftuar për datën dhe orën e zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë.

Sipas procesverbalit të datës 10.11.2025, të hartuar nga Komiteti i Pranimit për Lëvizjen Paralele, rezulton se, kandidatja H. Albunesa është paraqitur dhe ka marrë pjesë në intervistën e strukturuar me gojë, në procedurën e konkurrimit me kod #7251, në fazën e lëvizjes paralele, për pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm në Administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër*”, si dhe ka nënshkruar deklaratën për regjistrimin me zë të intervistës.

Gjithashtu, rezulton se, përpara zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë, anëtarët e KLP-së kanë nënshkruar deklaratën e paanshmërisë, si dhe kanë hartuar listën e pyetjeve të intervistës së strukturuar me gojë.

Në përfundimit të intervistës së strukturuar, datë 10.11.2025, KPLP-ja ka hartuar Formularin *“Për vlerësimin individual të kandidatit”* dhe në datën 14.11.2025, ky organ ka hartuar raportin *“Për rezultatin e procedurës së lëvizjes paralele”*, ku rezulton se kandidatja H. Albunesa është vlerësuar me 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar dhe 22 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë, në total vlerësuar me 62 pikë.

Pas njoftimit të rezultatit, kandidatja ka paraqitur ankesë duke kërkuar rivlerësim të intervistës. Në vijim, sipas procesverbalit të datës 21.11.2025, pranë DAP, është zhvilluar seanca e ballafaqimit në prezencë të dy anëtarëve të KPLP-së dhe kandates, *(në mungesë të përfaqësuesit DAP, i cili ndodhej me leje të zakonshme)*, ku janë ridëgjuar pyetjet dhe janë dhënë sqarime për vlerësimin përkatës.

Pas kësaj seance, kandidatja ka kërkuar sërisht rivlerësim për katër pyetje të intervistës së strukturuar me gojë, konkretisht për pyetjet nr. 3, 4, 5 dhe 6.

Në vijim, ankesa është shqyrtuar nga KPLP-ja, fakt i dokumentuar në procesverbalin e datës 27.11.2025, si dhe ka njoftuar kandidaten me shkresën nr.5636/1 prot., datë 03.12.2025, të DAP.

Rezulton se, pas shqyrtimit të ankesës KPLP ka vendosur të njëjtin vlerësim përfundimtar për kandidaten Hermina Albunesa, që është 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar dhe 22 pikë për intervistën e strukturuar me gojë, në total 62 pikë nga 100 të mundshme.

Në vijim, KPLP-ja, në zbatim të pikës 24 dhe 25, të Kreut II, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, me aktin administrative të datës 03.12.2025, ka vendosur përfundimin e procedurës së konkurrimit për fazën e lëvizjes paralele për plotësimin e pozicionit *“Sekretar i Përgjithshëm në Administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër - klasa e pagës III-1”*, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, pa fitues.

Ndërkohë, në vijim të procesit të verifikimit, Komisioneri është njohur nga DAP, me faktin se, kandidatja Hermina Albunesa i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesë padinë nr. 7285, datë 16.01.2026, me objekt:

“1. Vendosjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar procedurën e konkurrimit/lëvizjes paralele për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, pranë institucionit të Prefektit Qarku Shkodër, deri në përfundimin e gjykimit administrativ; marrjes edhe të masave të tjera të përshtatshme, nga gjykata, në rastet kur vetëm pezullimi nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme;

2. Konstatimin e paligjshmërisë dhe shfuqizimi i vendimit/aktit administrativ të s'kualifikimit të paditësit nga procedura e lëvizjes paralele për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, i kryer përmes intervistës së strukturuar me gojë;
3. Konstatimin e paligjshmërisë së procedurës së vlerësimit të intervistës me gojë; anulimin e aktit dhe rivendosjen e ligjshmërisë;
4. Konstatimin e paligjshmërisë së procedurës administrative, për shkelje të ligjit nr.152/2013 dhe parimeve të shërbimit civil; parregullsinë e përbërjes së Komisionit ad hoc;
5. Detyrimin e institucionit të përsërisë procedurën për paditësen, në përputhje me ligjin, me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë përmes rivlerësimit nga një komision tjetër;
6. Konstatimin e diskriminimit, dëmshpërblimin moral në vlerën 1.500.000 lekë dhe kthimin në gjendjen e mëparshme.”

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, referuar paragrafit 3, të nenit 36, të ligjit nr.8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i cili sanksionon se, asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata, hetimi administrativ nuk mund të vijojë më tej, pasi rasti në fjalë do të zgjidhet në mënyrë përfundimtare nëpërmjet një vendimi gjyqësor ku do të rregullohen edhe pasojat e ardhura.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të nenit 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile”, i ndryshuar, nenit 90, pika 2, e ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 16, pika 6, e Rregullores “Për procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, të filluar në bazë të informacionit nr.1172 prot., datë 29.12.2025, të dërguar nga kandidatja Hermina Albunesa, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit me kod #7251, për plotësimin e pozicionit “Sekretar i Përgjithshëm”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër, të shpallur nga DAP, pasi mosmarrëveshja është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Departamentit të Administratës Publike, Prefekti i Qarkut Shkodër, si dhe kandidatja Hermina Albunesa.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)

Punoi: A. Kabali

Pranoi: L. Zhapa

Miratoi: A. Basha